

# GARA PËR BIZNESE TË GJELBRA DHE IDE INOVATIVE 2022

**Shënim: Është shtyrë afati për aplikim deri më 18 maj 2022.**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gara për Ide të Gjelbra dhe Inovative është garë e cila synon të zhvillojë inovacionin për ide biznesi të gjelbra në nivel lokal dhe të përkrahë rolin e bizneseve në angazhimin e komuniteteve lokale për të gjeneruar ide biznesi të bazuara në shfrytëzimin e burimeve lokale, ringjalljen e traditave të prodhimit dhe tregjeve lokale.

Ballkan Green Ideas, zbatohet në gjatë vende të Ballkanit Perëndimorë, si dhe në Greqi. Në garën regjionale marrin pjesë gjithsej 21 ide garuese, 3 për secilin vend.

Kjo garë siguron mbështetje financiare dhe mentorim të planifikuar për idetë dhe bizneset e përzgjedhura që ofrojnë zgjidhje inovative dhe kontribuojnë në arritjen e shtatë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Greqisë:

- SDG 2 - Arritja e sigurisë ushqimore dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.
- SDG 7 - Energji e Pastër
- SDG 8 - Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme dhe punë të denjë për të gjithë.
- SDG 11 - Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm.
- SDG 12 - Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
- SDG 13 - Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij.
- SDG 15 - Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së bio-diversitetit.

Gara e Bizneseve të Gjelbra bazohet në parimet e përgjegjësisë ndaj mjedisit, sjelljes etike, diversitetit, përfshirjes dhe fuqizimit, autonomisë me qëllim promovimin e mirëqenies së komuniteteve lokale, duke fuqizuar sipërmarrjen dhe u mundësuar njerëzve të përmbushin potencialin e tyre.

## QËLLIMI I GARËS

Qëllimi i garës së Bizneseve të Gjelbra është të mbështesë nisma të biznesit të cilat synojnë përfshirjen sociale përmes integritit, punësimit, si dhe zhvillimin ekonomik lokal, përmes ideve miqësore ndaj mjedisit.

## PËRKRAHJA FINANCIARE

Të interesuarit duhet të dërgojnë propozim në njërin nga LOT-et vijuese:

*LOT 1: Ide Biznesi në Fazë Konceptuale* - i referohet propozimeve të biznesit që janë në një fazë konceptuale. Fondi do të mbështesë propozime për një periudhë kohore jo më gjatë se një vit.

*LOT 2: Biznes në Fazat e Para të Zhvillimit* - i referohet propozimeve të biznesit që janë në fazat e para të zhvillimit, produktet apo shërbimet janë të pranishme në treg prej jo më shumë se tre (3) vite.

Inkurajohet bashkëfinancimi nga burime alternative!

## KUSH MUND TË APLIKOJË?

Konkursi është i hapur për:

- Individë – Në rastin kur propozimi është shpallur fitues do të kërkohet të regjistrohet si një entitet ligjor përpara nënshkrimit të kontratës dhe ndarjes së fondeve. Forma ligjore e përzgjedhur është në varësi të individit dhe duhet të parashikohet në propozimin e dërguar. **Individët nuk mund të aplikojnë në LOT 2**
- Ndërmarrjet sociale me një balancë pozitive jo më shumë se 10,000 EUR.
- Biznesi i vogël në vend me një fitim vjetor jo më shumë se 10,000 EUR.
- Organizatat jofitimprurëse me një bilanc pozitiv maksimal prej 10,000 EUR, duke iu referuar OJQ-ve që kanë veprimtari ekonomike (shesin produkte ose ofrojnë shërbime), me një fitim vjetor jo më të lartë se 10,000 EUR pa llogaritur dhurime ose fonde të tjera.

## KRITERET PËR LOT 1

- Ideja është ende në fazë konceptuale, produktet apo shërbimet nuk janë të pranishme në treg; Ideja është ende në fazat e hershme të zhvillimit dhe nuk ekziston për më shumë se 3 vjet. (Kjo i referohet idesë ose projektit, jo vetë kompanisë / OJQ-së);

- Ideja bazohet kryesisht në përdorimin e burimeve lokale, duke përfshirë punësimin e njerëzve lokalë dhe shfrytëzimin e aftësive tradicionale;
- Ideja ka një vizion, apo një plan veprimi për qëndrueshmërinë mjedisore;
- Ideja ka një plan për qëndrueshmëri ekonomike dhe/apo rritjen e vazhdueshme;
- Ideja ka një qasje inovative dhe ndikim të vlefshëm shoqëror;
- Ideja bazohet në një vlerësim të tregut lokal dhe njeh konkurrentët dhe avantazhet krahasuese;
- Ideja është inovatore në krahasim me bizneset dhe nismat e tjera në komunitet;
- Ideja fokusohet ose kontribuon në njërin prej SDG-ve të renditura më sipër në 2, 7, 8, 11, 12, 13 dhe 15.

## KRITERET PËR LOT 2

- Biznesi është në fazat e para të zhvillimit të tij, produktet apo shërbimet e tij janë të pranishme në treg për një periudhë kohore jo më shumë se 3 vite;
- Biznesi bazohet kryesisht në përdorimin e burimeve lokale, duke përfshirë punësimin e njerëzve lokalë;
- Biznesi ka një vizion, apo një plan veprimi për qëndrueshmërinë mjedisore;
- Biznesi ka një plan për qëndrueshmëri ekonomike dhe/apo rritjen e vazhdueshme;
- Biznesi ka një qasje inovative dhe ndikim të vlefshëm shoqëror;
- Biznesi bazohet në një vlerësim të tregut lokal dhe njeh konkurrentët dhe avantazhet krahasuese;
- Biznesi është inovator në krahasim me bizneset dhe nismat e tjera në komunitet;
- Biznesi fokusohet ose kontribuon në njërin prej SDG-ve të renditura 2, 7, 8, 11, 12, 13 dhe 15.

## DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR APLIKIM

1. Propozimi narrativ;
2. Planifikimi financiar;
3. Modeli i Biznesit;
4. Një dokument që vërteton statusin ligjor të entitetit që aplikon: **(Jo për Individët);**
5. Pasqyrat Financiare të vitit të fundit **(Jo për Individët).**

## PROCESI I PËRZGJEDHJES

Procesi i vlerësimit do të realizohet në dy faza:

- *Faza e parë* përfshinë përzgjedhjen e propozimeve që plotësojnë kriteret bazë të aplikimit, së bashku me dokumentacionin përkatës.

- *Faza e dytë* përfshinë organizimin e një gare të hapur të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë.
- *Idetë e përzgjedhura nga konkursi kombëtare do të do të garojnë për fondin rajonal.*
- Në garën rajonale BGI 2022, garuesit e përzgjedhur për LOT 1, do të garojnë për të fituar fondin e shpërblimit në vlerë prej 5,000\$. Kurse, për LOT 2, do të garojnë për të fituar fondin e shpërblimit në vlerë prej 10,000\$.
- Fondi i shpërblimeve në garën rajonale, është në vlerë 40,000\$. Prej tyre, tre çmime në vlerë nga 10,000\$ do të jepen për tre ide nga LOT 2. Ndërsa, dy çmime në vlerë nga 5,000 \$, do të jepen për dy ide për LOT 1.
- Të përzgjedhurit nga konkursi në Kosovë do të garojnë për fondet e cekura, së bashku me fituesit prej vendeve të rajonit.
- Tre propozime do të përzgjidhen nga Kosova, e të cilët do të mund të marrin pjesë në garën rajonale të BGI.
- Përzgjedhja e garuesve nga Kosova do të bëhet nga LENS.

Për aplikantët e interesuar, do të organizohet një punëtori online për të mësuar më shumë për garën dhe procesin e aplikimi. Nëse jeni të interesuar, ju lutem na dërgoni shprehje të interesimit për pjesëmarrje në “Green Workshop”, duke na shkruar në e-mail adresën: [application@ngolens.org](mailto:application@ngolens.org), përpara datës, 11 Maj 2022.

Aplikimet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike, me titull “**Gara Për Biznese Të Gjelbra Dhe Ide Inovative 2022**”, në e-mailen:

**[application@ngolens.org](mailto:application@ngolens.org)**

**Afati i fundit për aplikim është 18 Maj 2022!**